



## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 01-060/01-12408, datë: 26 Shkurt 2026.

Në bazë të nenit 11, nenit 12.2. pika d) dhe nenit 54 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431, dt.30 Shtator 2020, në propozim të kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës në takimin e mbajtur me datë: 26 Shkurt 2026, merr:

### VENDIM

Nr.12/2026

#### Mbi ndarjen - rezervimin e postit të Zëvendës/Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete

1. **Mirsad Berisha** përfaqësues i komunitetit jo shumicë (komuniteti egjiptian) që ka marrë pjesë në zgjedhje me listën e hapur të kandidatëve për anëtarë të kuvendit të komunës së Pejës, me subjektin politik “PLE”, e me qellim të promovimit të drejtave të komuniteteve jo shumicë në komunë, **i ndahet–rezervohet posti i Zëvendës/Kryesuesit për komunitete të Komunës së Pejës.**
2. Zëvendës/kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, zgjidhet për mandat të njëjtte sikurse anëtarët e kuvendit të komunës.
3. Zëvendës/kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete promovon dialog ndërkomunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo shumicë në mbledhjet e kuvendit. Detyrat e zëvendës/kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete përcaktohen me nenin 55 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të dhe dispozita tjera ligjore në fuqi.
4. Zëvendës/kryesuesit për komunitete të Komunës së Pejës për punën e tij, paguhet në bazë të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës.
6. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL

Kryetarit të Komunës.

Të emëruarit.

Zyrës së personelit.

DBF, dhe Arkivë.

